



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 10.03.2025

Nr: 15

Ora: 11:45

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 5, DATË 06.03.2025, DEPOZITUAR
NGA PARTIA “MINORITETI ETNIK GREK PËR TË ARDHMEN” (MEGA)**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 10.03.2025, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

- ANKUES:** Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA), përfaqësuar nga Kryetari i Partisë z. Lefter Nika
- OBJEKT:** Shfuqizimi i Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 228, datë 03.03.2025 “Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA) me kryetar z. Kristaq Kiço”
- PALË E INTERESUAR:** Z. Kristaq Kiço, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Av. Thoma Miço
- BAZË LIGJORE:** Neni 124/1, pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin. Në zbatim të nenit 64 të K.Zgjedhor, jo më vonë se 75 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, partitë politike kanë të drejtë për të paraqitur kërkesë për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ. Po ashtu, në zbatim të nenit 63 të K.Zgjedhor, regjistrimi si subjekt zgjedhor është kusht *sine qua non* që një parti politike apo koalicion partish politike, të mund të paraqesin listë kandidatësh për zgjedhjet në Kuvend.
2. Referuar sa më sipër, si fillim Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” nëpërmjet Kryetarit z. Kristo Kiço, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 1080 prot., datë 18.02.2025, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025 dhe më tej Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” nëpërmjet Kryetarit Z. Lefter Nika, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 1258 prot., datë 24.02.2025, për t'u regjistruar po ashtu si subjekt zgjedhor, pra dy kërkesa për të regjistruar të njëjtin subjekt zgjedhor, por me kryetarë të ndryshëm.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 228, datë 03.03.2025 “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Politike “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me kryetar z. Kristo Kiço, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 11 maj 2025”, vendosi regjistrimin e partisë politike Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me kryetar z. Kristo Kiço, me shkronjat nistore “MEGA”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
4. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur kërkesën ankimore me nr. 5, datë 06.03.2025, kërkuesi z. Lefter Nika, përfaqësuar nga juristi me autorizim z. Petraq Dhimitri, nëpërmjet të cilës kërkon shfuqizimin e vendimit të sipërcituar.
5. Në përputhje me rregulloren “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, u hodh shorti për caktimin e relatorit për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore dhe u caktua anëtari z. Ledio Braho, si relator i shqyrtimit të kësaj çështjeje.
6. Po në datën 10.03.2025, KAS-i zhvilloi seancën e verifikimit të plotësisimit të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore, në prani të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së dhe me përfaqësimin e z. Lefter Nika, z. Petraq Dhimitri për Partinë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” dhe z. Kristo Kiço i përfaqësuar nga Av. Thoma Miço, si person i interesuar.
7. Pala ankuese i kërkoi Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) që, bazuar në nenin 21/b të Kodit Zgjedhor, të pranojë kërkesën për shfuqizimin e Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 228, datë 03.03.2025 “Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA) me kryetar z. Kristaq Kiço” dhe regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA) me kryetar z. Lefter Nika.
8. Përfaqësuesi në seancë i z. Lefter Nika, z. Dhimitri në ankimin e tij pretendoi se:

- NËPËRMJET vendimit nr. 05, datë 10.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pranoi kërkesën e Partisë “MEGA”, për regjistrimin në Regjistrin e Partive Politike me kryetar z. Lefter Nika;
- Më datë 24.02.2025, z. Lefter Nika, paraqiti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacionin për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë “MEGA”;
- Po në datë 24.02.2025, z. Lefter Nika u njoh me faktin se kjo parti politike figuronte e regjistruar si subjekt zgjedhor nga kryetari i mëparshëm i saj z. Kriqaz Kriqaz;
- Kundër vendimit nr. 5, datë 10.02.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u depozitua ankimi nga z. Kristaq Kriqaz;
- Më datë 03.03.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi ankimin e z. Kristaq Kriqaz kundër vendimit nr. 5, datë 10.02.2025, duke vendosur “Mospranimin e ankimit”;
- Më datë 03.03.2025, u bë me dije vendimi nr. 228, datë 03.03.2025 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet të cilit u vendos regjistrimi i Partisë “MEGA”, me kryetar z. Kristo Kriqaz;
- Vendimi nr. 2, datë 28.09.2024 i Këshillit Kombëtar të përfaqësuesve të Partisë “MEGA”, ka përcaktuar datën 23.11.2024, datë për realizimin e zgjedhjeve për kryetarin e partisë;
- Me vendimin nr. 16, datë 23.11.2024, të Komisionit Zgjedhor të Partisë “MEGA”, u vendos që kryetar do të jetë z. Lefter Nika me 1048 vota;
- Në zbatim të ligjit nr. 8580/2000 “Për partitë politike” të ndryshuar, z. Nika i’u drejtua Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë për regjistrimin e kryetarit të Partisë “MEGA”.

9. Përfaqësuesi me prokurë i z. Kristaq Kriqaz, në pretendimet e tij deklaroi se në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 64 të K.Zgjedhor, kanë depozituar në KQZ dokumentacionin konform rregullave dhe KShZ me vendimin e tij, në përputhje me parashikimet ligjore, ka vendosur regjistrimin e subjektit zgjedhor “MEGA”, me kryetar z. Kristaq Kriqaz.

10. Përfaqësuesi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve parashitri në shqyrtimin e kërkesës rrethanat e çështjes dhe kërkoi lënien në fuqi të vendimit të KShZ.

11. Pasi dëgjoi shpjegimet e palëve dhe përgjigjet e pyetjeve, mori në shqyrtim dhe administroi provat si vijojnë:

- Kërkesën Ankimore nr. 5, datë 06.03.2025, depozituar nga Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”;
- Vendimin nr. 228, datë 03.03.2025 “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Politike “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me kryetar z. Kristo Kriqaz, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 11 maj 2025” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Vendimin nr. 5, datë 10.02.2025 “Për depozitim në regjistrin e Partive Politike” të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë;
- Vendimin nr. Regj. Themeli 1467/307, datë 03.03.2025 “Për shqyrtimin e ankimit”, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë;
- Ankimin, me ankues z. Kristo Kriqaz, depozituar më datë 07.03.2025, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

- Statutin e Partisë “MEGA”, Minoriteti Grek për të Ardhmen, me nr. 1011 Rep., Nr. 437/7 Kol., i datës 20.03.2010

KAS-i konstatoi:

12. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në hyrje të vendimit objekt i këtij shqyrtimi administrativ, ndër të tjera, ka cituar se:

“Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se kërkesat e depozituara në KQZ nga kërkuesit e sipër cituar lidhen midis tyre për nga objekti, pasi bëhet fjalë për të njëjtën parti politike që kërkon të regjistrohet si subjekt zgjedhor dhe për këtë arsye duhet të shqyrtohen së bashku.

Kërkuesi Z. Kristo Kiço, në cilësinë e Kryetarit, ka depozituar kërkesën për regjistrimin e Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, datë 09.01.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me iniciale “MEGA”, me Kryetar Z. Kristo Kiço, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);

c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” me shkronja nistore “MEGA”, me adresë: Rruga e Flamurit, Lgj. 1, Sarandë;

b) Kryetari i partisë është Z. Kristo Kiço, me adresë: Rruga “Alex Verli”, Lgj. 1, Sarandë;

c) Financieri i partisë është Z. Tafil Kola, me adresë: Lgj. 1, Sarandë;

ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Ilia Nikolla, me adresë: Lgj. 3, Sarandë;

d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkuesi Z. Lefter Nika, bashkëlidhur kërkesës së tij për regjistrimin e Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” ka paraqitur dokumentacionin vijues:

a) Vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, i cili nuk ka marrë formë të prerë;

b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ 04 02)

c) Deklarata për hapje hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ 04 03).

e) Emri zyrtar i partisë është Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” me shkronja nistore “MEGA”, me adresë: “Selia e Flamurit”, Lgj. 1, Sarandë;

f) Kryetari i partisë është Z. Lefter Nika, me adresë: Rruga “Bilal Xhaferri”, Lgj. 4, Pll. 4 Sarandë;

g) Financieri i partisë është Z. Thimjo Gozhdari, me adresë: Rruga “Gjergj Aranitasi”. Lgj.1, Pll. 18, Sarandë;

ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Petraq Dhimitri, me adresë: Rruga “Panorama”, Nj.9, Ndr.7, H.8, Ap. 33, Tiranë;

h) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Nëpërmjet vërtetimit të datës 27.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se Z. Kristo Kiço, ka paraqitur ankim kundër vendimit për regjistrimin e partisë politike Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA) me kryetar z. Lefter Nika”

dhe më tej ka arritur në përfundimin se:

“Kërkesa e Z. Lefter Nika, për regjistrimin e Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, si subjekt zgjedhor në këto zgjedhje, nuk e përmbush detyrimin e përcaktuar në nenin 64 pika 2, gërma “a”. Sipas kësaj pike, së bashku me dokumentet e kandidimit për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ “Vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë”.

13. Rregullat e K.Zgjedhor për regjistrimin e subjekteve zgjedhore kanë qëllim të garantojnë konkurueshmërinë në zgjedhje, duke siguruar barazinë në garë midis partive politike, koalicioneve dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit. Kjo do të thotë se qëllimi i rregullave nuk është në asnjë rast përjashtimi, por përfshirja dhe lehtësimi i kushteve për garë.
14. Të gjitha kërkesat e tjera për regjistrimin kanë lidhje me deklarin e vullnetit të subjektit. Plotësimi i deklaratave kërkohet me qëllim që të sigurohet rregullshmëria e procesit zgjedhor dhe lehtësimi i mundësive për komunikim, mbikëqyrje, monitorim dhe llogaridhënie. Kërkesat për deklarata shoqëruese nuk formojnë në asnjë rast kusht për përjashtimin e subjektit nga zgjedhjet.
15. Neni 64 i K.Zgjedhor ka përfshirë në listën e kërkesave dhe vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë (Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) (shkronja “a” e pikës 2). Ky dokument shërben për të identifikuar subjektin dhe për të provuar se subjekti kërkues ka personalitet juridik, për pasojë ka zotësi për të vepruar, për pasojë legjitimohet në të drejtën për të kërkuar regjistrimin në zgjedhje. Ky dokument është një akt zyrtar, i nxjerrë nga një regjistër zyrtar (Regjistri i Partive Politike që administrohet nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë), i cili merret dhe disponohet nga subjekti, por subjekti nuk ka asnjë mundësi ta modifikojë sipas dëshirës përmbajtjen e tij.
16. **Administrimi nga KQZ-ja i vërtetimit të paraqitur në zbatim të shkronjës “a” të nenit 64 të K.Zgjedhor ka vlerë vetëm për të identifikuar subjektin kërkues dhe për të verifikuar nëse ai ka zotësi për të vepruar. Cilësinë e të qenit parti politike nuk mund t’a pretendojë çdo grupim personash. Që të mund të konkurrosh si parti politike duhet më parë të ekzistosh ligjërisht si e tillë. Sigurinë për këtë status e jep pikërisht ky dokument. Vërtetimi i depozituar në KQZ nga ana e personit të interesuar në këtë shqyrtim administrativ, nga z. Kristaq Kiço, në cilësinë e kryetarit të partisë “MEGA”, provon faktin që Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, me iniciale “MEGA”, është e regjistruar në regjistrin e partive politike që nga data 21.06.2010 dhe po ashtu nga po ky vërtetim rezulton se kryetar i kësaj partie është pikërisht personi i interesuar z. Kristaq Kiço. Ndërkohë që z. Lefter Nika, i cili po ashtu pretendon se është zgjedhur kryetar i të njëjtës parti, nuk rezulton që të ketë depozituar vërtetimin në zbatim të nenit 64 pika 2 shkronja “a” të K.Zgjedhor, por ka depozituar vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, që në vijim është depozituar edhe vendimi i arsyetuar Nr. 5, datë 10.02.2025 sipas të cilit gjykata ka vendosur:**
 1. *Pranimin e kërkesës.*
 2. *Regjistrimin në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë të z. Lefter Nika si kryetar i Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA).*

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, që të pasqyrojë në regjistrin e partive politike, Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA), të z. Lefter Nika si kryetar të Partisë.
4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

17. **Kjo do të thotë se Partia MEGA e përfaqësuar nga personi i interesuar z. Kristaq Kiço e ka plotësuar kërkesën e shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 64, ndërkohë që Partia “MEGA” e përfaqësuar nga z. Lefter Nika nuk ka disponuar për plotësimin e kësaj kërkesë duke mos depozituar asnjë vërtetim si përpara Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ashtu edhe përpara KAS. Në lidhje me mungesën e këtij vërtetimi, pala ankuese argumentoi se është në pamundësi objektive të depozitimit të këtij akti shkresor pasi vendimi Nr. 5, datë 10.02.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë ende nuk ka marrë formë të prerë për shkak se pala e interesuar z. Kristaq Kiço, në datë 07.03.2025 ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit të po kësaj gjykate me objekt “disponimin e ankimit” sipas të cilit është vendosur:**

18. ***“1. Mospranimi i ankimit të ankuesit Kristo Kiço kundër vendimit gjyqësor nr. 5, datë 10.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, sepse nuk legjitimohet që të bëjë ankim.***

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë, brenda afatit ligjor 5 ditor, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit përkundrejt ankuesit z. Kristo Kiço.

3. U shpall në dhomë këshillimi, sot, më datë 3 Mars 2025”.

19. Në lidhje me sa më sipër, është me vend për t’ju referuar edhe ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, i cili në nenin 13 paragrafi i parë parashikon se “Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji”.

Më tej në nenin 14 parashikon se:

*“Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme.
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve”*

dhe më tej në nenin 15 parashikon se:

“Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit, të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës”.

20. Nga këto dispozita del qartë, se ashtu si për regjistrimin e partisë politike, edhe për ndryshimet në regjistrimet e mëparshme, ndiqet e njëjta procedurë nëpërmjet kërkesës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vendimmarrja e së cilës mund të ankimohet pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, siç ka ndodhur edhe në rastin objekt shqyrtimi administrativ.

21. Në lidhje me këtë fakt, pala ankimuese ju referua edhe praktikës gjyqësore, më konkretisht vendimit Nr. 786, datë 27.12.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili përveçse sa ka cituar pala ankimuese, arsyeton ndër të tjera edhe:

“25. Gjithashtu, kontrolli gjyqësor ndaj akteve të krijuara nga organet drejtuese të subjekteve politike, është përcaktuar në ligj pikërisht edhe për faktin që të garantohet se këto akte dhe vullnete të shprehura nga organet e subjekteve politike të jenë në përputhje me ligjin, si dhe aktet statutores të këtyre subjekteve, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të tyre dhe mos lejimit të krijimit të precedentëve negativë, të cilët mund të sjellin ndikime negative në jetën publike. Partitë politike janë subjekte që kanë interes publik dhe ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetën publike, shtetërore, institucionale të një vendi. Nëpërmjet formës së organizimit dhe veprimtarisë së tyre sipas parimeve demokratike, këto subjekte ndikojnë në zhvillimin e të drejtave politike, sociale, ekonomike por edhe ligjore, pasi nëpërmjet veprimtarisë së tyre ata luajnë një rol thelbësor dhe aktiv në zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtyre të drejtave, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje, përfaqësojnë popullin në organet e zgjedhura të pushtetit.

...

27. Në këtë procedurë kontrolli gjyqësor (homologimi), gjykata ka detyrimin ligjor që të fokusojë dhe kushtëzojë vlerësimin e saj në kontrollin e ligjshmërisë të: (i) procedurave të ndjekura për thirrjen e mbledhjes së organeve vendimarrëse të partisë, kuvendit kombëtar, kryesisë apo organeve të tjera drejtuese me të drejtë vote dhe vendimarrëse; (ii) vlefshmërinë e njoftimeve të kryera për mbledhjen e këtyre forumeve; (iii) përcaktimin dhe verifikimin e kuorumit të nevojshëm për të mbledhur forumet dhe organet drejtuesë të subjektit politik, si dhe për të marrë vendimet përkatëse; si dhe (vi) kontrollin e përputhshmërisë e realizimit të të gjitha këtyre procedurave me ligjin specifik, përcaktimet e statutit të subjektit juridik dhe akteve rregullatore të brendshme, me qëllim përcaktimin e vlefshmërisë së akteve të nxjerra nga këto procedura vendimarrëse nga pikëpamja e ligjit dhe pasqyrimin e tyre në regjistrin përkatës të partive politike”.

22. Në lidhje me sa më sipër, nuk është në kompetencën e organeve të KQZ, si e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ashtu edhe e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve që të zgjidhë mosmarrëveshjet brenda një partie politike dhe të identifikojë nëse kryetar i një partie është një person i tretë i ndryshëm nga ai që pasqyrohet në Regjistrin e Partive Politike që administrohet nga gjykata, përveç rasteve kur vetë ky i fundit ka deleguar tagrin e drejtimit të partisë, qëndrim ky që është mbajtur edhe në vendimin nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS, ku ndër të tjera është arsyetuar se:

“Mënyra se si partitë politike zgjedhin të delegojnë tagrin e drejtimit të partisë tek një ose më shumë individë, në rastet kur drejtuesi i subjektit jep dorëheqjen apo ndërron jetë, nuk lidhet domosdoshmërisht me depozitimin në gjykatë, pasi kjo është një procedurë që ligji zgjedhor nuk e parashikon dhe për më tepër, rregullimi i brendshëm i partive politike nuk mund të përcaktohet nga KQZ apo organe të tjera shtetërore. Në çdo rast subjekti zgjedhor nuk mund të pengohet të marrë pjesë në zgjedhje, sa kohë që personi që ushtron detyrën e Kryetarit pranon të përmbushë detyrimet formale të regjistrimit, përfshi edhe Deklaratën Solemne të vendosur me ndryshimet e fundit të vitin 2020 në Kodin Zgjedhor, si një akt deklarativ i vullnetit të mirë për të zbatuar ligjin”.

23. Në rastin objekt shqyrtimi administrativ, ndodhemi në kushte të tjera, pasi Partia MEGA është regjistruar me vendimin objekt ankimi sipas të dhënave të pasqyruara në Regjistrin e Partive Politike në gjykatë dhe pretendimi ngrihet nga një palë e tretë, por ky pretendim nuk mund të njihet nga KShZ apo KAS, pa u formalizuar me një vendim gjykate të formës së prerë, në të kundërt KQZ do të ishte në shkelje të nenit 64, pika 2, shkronja “a”, të K.Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 143, pika 1, shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 5, datë 06.03.2025, me ankues Partia “Minoriteti Grek për të Ardhmen”, MEGA, përfaqësuar nga kryetari i Partisë z. Lefter Nika;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 228, datë 03.03.2025, “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Politike “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me kryetar z. Kristo Kiço, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 11 Maj 2025”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në nenin 145 pika 1 të K.Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

U shpall sot, më datë 10.03.2025

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Iirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar